Shërbimet përkthyes në parlament (nëse ka?) duhet të lidhen direkt me shërbimet përkthyes qeveritare në mënyrë që të shmanget puna e dyfishtë dhe për të shkëmbyer informacion, veçanërisht rreth legjislacionit të përkthyer.

Komisioni i Integritit duhet të marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve për çështjet e BE-së në parlamentet kombëtare dhe Parlamentin Europian, njohur gjithashtu si Konferenca e Komisioneve të Çështjeve Europiane (COSAC), e cila zhvillohet dy herë në vit. COSAC siguron shkëmbimin e informacionit ndërmjet komisioneve për çështjet e BE-së dhe Parlamentit Europian, dhe diskuton çështjet relevante për zhvillimin e ardhshëm të Bashkimit Europian.

Po ngrihet një bazë e re të dhënash (IPEX – Shkëmbimi i Informacionit Ndërpametar të BE-së) në mënyrë që të përmirësohet shkëmbimi i informacionit ndërmjet parlamenteve kombëtare dhe është e këshillueshme që të krijohet një bashkëpunim me të, si edhe me Qendrën Europiane të Kërkimit dhe Dokumentacionit Parlamentar (ECPRD) i cili grumbullon dhe publikon të dhëna dhe analiza krahasuese nga parlamentet kombëtare të BE-së.

2.4 Kapaciteti Administrativ

Situata aktuale me vetëm një (1) këshilltar parlamentar për Komisionin e BE-së nuk siguron punë të suksesshme të Komisionit, duke marrë parasysh të gjitha detyrat e tij, veçanërisht rolin në rritje të Komisionit në kotrollin/shqyrtimin politik, duke kontrolluar harmonizimin ligjor dhe bashkëpunimin parlamentar.

Pavarësisht se si përgatitet një legjislacion i mirë nga Parlamenti Shqiptar, nëse nuk punohet me burimet njerëzore dhe pa pasur stafin e duhur për të ndihmuar anëtarët e Komisionit, Parlamenti do të luante një rol jo të rëndësishëm në procesin para pranimin dhe nuk do të ishte i aftë të ndiqte hapat qeveritarë.

Për këtë rekomandohet që brenda Parlamentit të ngrihet Departamenti i BE-së, stafi i të cilit do të rritet ngadalë nga 4-5 në 2-3 vjetët e ardhshëm dhe detyrat e të cilit do të jenë ato që u paraqitën më lartë.¹³ Kryetari i këtij Departamenti duhet të jetë një ekspert dhe sekretari i Komisionit të BE-së dhe sekretari i Komisionit të Përbashkët Parlamentar. Kryetari i Departamentit, si

al progress reports on Albania's travel towards EU that are to be prepared by the EU Commission and deserve detailed deliberation.

From this day forward, the parliamentary cooperation will increase every year and this is the another reason for having the qualified staff to assist in preparing the materials and speeches and separating the tasks and competences from those of the Committee for Foreign Relations. Namely NATO, IPU, Council of Europe, etc. have nothing to do with the European Union and fall within the competences of the Foreign Affairs Committee. Cooperation with Ministry of Integration should be intensified and representatives from the Ministry should be present at all sessions.

Translation services in parliament (if any?) should be directly linked to the governmental translations services in order to avoid double work and to exchange information, about the translated legislation especially.

The Committee on EU Affairs should participate at the meetings of EU affairs committees from the national parliaments and the European Parliament, also known as the Conference of European Affairs Committees (COSAC), which are held twice a year. COSAC provides for the exchange of information between EU affairs committees from national parliaments and the European Parliament, and discusses issues relevant to the future development of the European Union. A new database (IPEX - Interparliamentary EU Information Exchange) is being set up in order to improve the exchange of information among national parliaments and it is advisable to establish cooperation with it, as well as with the European Centre of Parliamentary Research and Documentation (ECPRD) which collects and publishes data and comparative analyses from EU national parliaments.

2.4 Administrative capacity

The present situation with only one (1) parliamentary adviser for the EU Committee does not ensure successful work of the Committee, taking into account all its obligations, especially the expanding role of the Committee in political scrutiny, checking legal harmonisation and parliamentary cooperation.

Regardless of how good legislation is being prepared by the Albanian Parliament, if no work is done in human resources and without having proper staff to assist members of the Committee, the Parliament will play only an insignificant role in the pre-accession process and will not be able to follow the governmental attempts.

It is therefore recommended to establish within the Parliament the EU Department, the staff of which would slowly grow to about 4-5 in the next 2-3 years and the

(vijon në faqen 9)

Raport

Rekomandime mbi Rolin e Komisionit Parlamentar të Integritimit Europian dhe mbi Procesin e Përafrimit të Legjislacionit në Kontekstin e Parlamentit Shqiptar¹.

(vijon nga faqja 8)

edhe stafi tjetër, duhet të zgjidhet nëpërmjet një tenderi pune të pavarur më mirë se sa të emërohet nga Kryetari i Parlamentit dhe duhet të jetë përgjegjës përpara Sekretarit të Përgjithshëm si kryetari i të gjithë stafit. Funkcionet politike të Kryetarit të Parlamentit dhe deputetëve, nga njëra anë, dhe funksioni profesional i Sekretarit të Përgjithshëm në lidhje me organizimin e punës dhe rekrutimin e personave në Asamble, nga ana tjetër, duhet të jenë qartësisht të ndara.

Në një të ardhme të afërt, një përfaqësues i përhershëm i Parlamentit (nga Departamenti Parlamentar i BE-së) duhet të transferohet në Parlamentin Europian siç u sugjerua në rekomandimet institucionale. Detyra e tij duhet të jetë për dy vjet, kohë mbas së cilës personi duhet të kthehet në Shqipëri dhe të zëvendësohet nga dikush tjetër nga Departamenti i BE-së. Kjo përqasje do ta bënte punën e një këshilltari të Parlamentit më tërheqëse dhe do të shtonte numrin e stafit kompetent vetëm për pak vjet.

Parlamenti mund të financojë studime pasuniversitare mbi BE-në jashtë vendit për një sërë studentësh dhe t'i kontraktojë ata të punojnë për Parlamentin pas studimeve të tyre.

Departamenti i BE-së duhet të punësojë të paktën një jurist sa më shpejt të jetë e mundur dhe numri i juristëve duhet të shtohet në dy ose tre. Puna e Sekretarit të Komisionit duhet të bëhet nga një profesionist parlamentar, jo nga deputeti, si u këshillua më sipër.

2.5. Konkluzione

Natyra e sugjerimeve dhe rekomandimeve është më shumë praktike sesa teorike. Ato kanë ardhur nga eksperiencia praktike e autorit në Parlamentin e një Shteti të ri Anëtar dhe janë për zhvillimin e një stafi të fortë profesional të Parlamentit i cili duhet të ofrojë një nivel të lartë shërbimi për Anëtarët e Parlamentit. Për këtë është e nevojshme organizimi i mirë institucional dhe një bazë e duhur ligjore, çka ekziston tashmë. Këtu është propozuar gjithashtu ngritja e një Departamenti të BE-së që do të punësojë nëpërmjet një tenderi publik ekspertët e zgjedhur për të cilët puna në Parlament do të jetë një sfidë. Bashkëpunimi i fortë parlamentar si edhe mundësia për të studiuar jashtë dhe për të qenë një përfaqësues i përhershëm i Parlamentit Shqiptar në Bruksel mund të krijojë një ambient konkurrues për anëtarët e ardhshëm të stafit mbështetës parlamentar.

Pa stafin e duhur, Parlamenti nuk do të ishte i aftë të luante plotësisht rolin e tij – i cili, konkretisht, do të përgatisë masën e pyetjeve të cilave do t'u përgjigjet Qeveria dhe materialet për sesionet, që do të kujtojnë kryetarin për çështjet që duhen vendosur në axhendë,

tasks of which would be as described above¹³. The head of this Department should be an expert and the secretary of the EU Committee and the secretary of the Joint Parliamentary Committee. The head of Department, as well as other staff, should be elected through an independent job tender rather than simply nominated by the Speaker and they should be accountable to the Secretary General as the head of all staff. Political functions of the Speaker and deputies, on one hand, and professional function of the Secretary General with regard to organising the work and recruiting the persons to the Assembly, on the other hand, should be clearly divided. In the near future, a permanent representative of the Parliament (from the parliamentary EU Department) should be seconded to the European Parliament as suggested in the institutional recommendations. The post should be for two years after which period the appointed person would return to the Albanian Parliament and be replaced by another person from the EU Department. This approach would make the job of the adviser to the Parliament more attractive and would increase the number of most competent staff in only several years.

The Parliament could offer to finance the EU postgraduate studies abroad to a number of students and contract them to work for the Parliament after their studies. The EU department should employ at least one lawyer as soon as possible and the number of lawyers should be increased to two or three. The work of the Secretary of the Committee should be done by a parliamentary professional, not the deputy, as already advised above.

2.5. Conclusions

The nature of all recommendations and suggestions are practical rather than theoretical. They have arisen from the author's practical experience in the Parliament of a new Member State and they are building on the strong professional staff of the Parliament which must offer a high level of service to the Members of Parliament. A precondition for this is good institutional organisation and proper legal base, which already exists. Also proposed here is establishment of the EU Department which will employ independent and through a public tender selected experts for whom working for the Parliament will be a challenge. Intense parliamentary cooperation as well as a possibility to study abroad and be a permanent representative of the Albanian Parliament in Brussels could create a competitive environment for prospective members of the parliamentary support staff.

Without the proper staff, the Parliament would not be able to play its role to the full – namely, who will prepare the heaps of questions to be answered by the Government and the materials for sessions, who will remind

(vijon në faqen 10)

Report

Rekomandime mbi Rolin e Komisionit Parlamentar të Integrimit European dhe mbi Procesin e Përafrimit të Legjislacionit në Kontekstin e Parlamentit Shqiptar¹.

(vijon nga faqja 9)

do të kontrollojë legjislacionin, do të organizojë udhëtimet jashtë, etj...

the chairman of the issues to put on agenda, who will check the legislation, organise the trips abroad, etc ...

Shënime

¹ Raporti bazohet në Termat e Referencës për një asistencë teknike afatshkurtër në lidhje me rolin e Parlamentit Shqiptar në procesin e Integrimit European, siç është rënë dakord ndërmjet z.Sokol Berberi, Drejtor Ekzekutiv i QSP-së dhe autorit, më 18 dhjetor, 2006.

² Të gjitha pikpamjet e shprehura në këtë Raport janë ide plotësisht personale të autorit dhe nuk reflektojnë ndonjë pikpamje të ndonjë institucioni të BE-së apo të ndonjë shteti anëtar të BE-së, apo të ndonjë organi tjetër.

* Ky material është përgatitur në kuadër të projektit "Rritja e rolit dhe përgjegjshmërisë së Parlamentit Shqiptar në procesin e Integrimit në BE nëpërmjet veprimtarive legjislative me pjesëmarrje të gjerë dhe transparente" zbatuar nga Qendra e Studimeve Parlamentare dhe mbështetur financiarisht nga Ambasada Britanike në Tiranë.

³ Ligji Nr. 9252, datë 8 qershor, 2004, "Mbi punën e Asamblesë në procesin e integrimit të Shqipërisë në BE", dhe propozuar nga z. Ilir Zela, Anëtar i Parlamentit.

⁴ Kushtetuta, Neni 7: Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin e pushteteve legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.

⁵ Rregullorja e Parlamentit, Vendimi Nr. 166, 2005, Neni 68

⁶ Rregullorja e Qeverisë, Vendimi i Qeverisë Nr.584, 2003, pika 19/d

⁷ Kushtetuta, Neni 83

⁸ Vendosur nga Vendimi Parlamentar Nr. 37, 16 Maj, 2002

⁹ Vendimi Parlamentar Nr.117, 26 Janar, 2004

¹⁰ Vetëm me 13 anëtarë është Komisioni i Përhershëm Parlamentar më i vogël në Parlamentin Shqiptar.

¹¹ Ashtu siç është paraqitur tashmë në këtë Raport

¹² Si Danimarka, Finlanda ose Sllovenia ku sesionet e Komisionit të BE janë të mbyllura për publikun. Arsyeja është që qëndrimet negociuese të qeverisë së tyre për mbledhjet e Këshillit të Ministrave nuk janë të hapura për publikun kur kërkohet konfirmimi parlamentar.

¹³ Shih rekomandimet institucionale

Footnotes

¹ The Report is based on the Scope of Work of the short-term technical assistance related to the role of Albanian Parliament in the European Integration process, as concluded between Mr. Sokol Berberi, Executive Director, ACPS and the author on December 18, 2006.

² All views expressed in this Report are strictly personal views of the author and do not reflect views of any EU institution or EU Member State or any other related body.

*This material is prepared in the framework of the project "Increased Transparency and Information of Parliament and Interest Groups on European Union Integration Process" which is being implemented by the Albanian Center for Parliamentary Studies and is financially supported by British Embassy in Tirana

³ Law No. 9252, dated July 8, 2004, "On the work of the Assembly in the process of Albania

's integration in the European Union", and proposed by Member of Parliament Mr. Ilir Zela.

⁴ The Constitution, Article 7: The system of government in the Republic of Albania is based on the separation and balancing of legislative, executive and judicial powers.

⁵ Parliamentary Rules of Procedure, Decision No. 166, 2005, Article 68

⁶ Governmental Rules of Procedure, Decision of Government No. 584, 2003, Point 19/d

⁷ The Constitution, Article 83

⁸ Set up by Parliamentary Decision No. 37, May 16, 2002

⁹ Parliamentary Decision No. 117, January 26, 2004

¹⁰ With 13 members only is the smallest Standing Committee in Albanian Parliament.

¹¹ As already described in this Report

¹² Like Denmark, Finland or Slovenia where sessions of EU Committees are closed for public. The reason is that their negotiating positions of government for Council of Ministers meetings are not public when asking for parliamentary confirmation.

¹³ See the Institutional recommendations

Primož Vehar,
Ekspert Ligjor Ndërkombëtar²

Primož Vehar,
International Legal Expert²

Nevoja për përsheptimin e procesit të ratifikimit të MSA-së.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), Shqipëria kaloi në një fazë më të avancuar të marrëdhënieve kontraktuale me Bashkimin Europian, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt etapave të mëtejshme në procesin e integritit evropian. Që nga ky moment procesi i integritit evropian të Shqipërisë kryesisht është përqendruar në ratifikimin e kësaj marrëveshje nga vendet anëtare të BE-së, si treguesi kryesor i ritmit dhe mënyrës se si Shqipëria po zbaton detyrimet e ndërmarra dhe jo si një moment procedural që shënon thjesht hyrjen në fuqi të MSA-së.

Praktika e vendeve që e kanë nënshkruar MSA para nesh, si Kroacia dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dëshmon se procesi i ratifikimit të marrëveshjes zgjat mesatarisht rreth dy vjet e gjysëm me një BE me 15 shtete anëtare. Por, rasti jonë paraqitet më i komplikuar pasi në momentin e nënshkrimit të MSA, BE kishte përjetuar zgjerimin e vet më të madh, duke shënuar kështu 25 shtete anëtare.

Në këtë drejtim, Shqipëria shënon precedentin e parë dhe të fundit sepse gjashtë muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes në BE u anëtarësua Bullgaria dhe Rumania, cka do të thotë se vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor që synojnë nënshkrimin e MSA-së do t'i duhet një punë më e madhe për ratifikimin e marrëveshjes.

Nënte muaj nga firmosja e MSA-së të vetmet vende që e kanë ratifikuar atë janë Letonia dhe Sllovenia, duke na ofruar një sinoptikë jo fort shpresëdhënëse për shpejtësinë e këtij procesi, krahasuar me Kroacinë dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Dhe për këtë situatë askush nuk ka pse çuditet. Skena politike shqiptare pas një procesi zgjedhor vendor sfilites dhe ende pa një rezultat përfundimtar që për fat të keq u konsiderua nga ndërkombehtarët si një "mundësi e humbur" shton skepticismin e BE-së në lidhje me vokacionin evropian të Shqipërisë.

Politika shqiptare duket se procesin e ratifikimit të MSA-së ia ka "besuar" diplomacisë apo vizitave të niveleve të larta, duke harruar detyrat e shtepisë. Por c'është më e keqja duke harruar se diplomacia shqiptare edhe sikur të kishte tiparet e një diplomacie të konsoliduar kërkon një histori suksesi reformash dhe bashkëpunimi politik që garanton vazhdimësinë e reformave, në mënyrë që ta "marketojë" atë në vendet anëtare të BE-së.

Përballë vendosmërisë evropiane, shprehur në Strategjinë e Zgjerimit se, pas anëtarimit të Bull-

garisë dhe Rumanisë, procesi i zgjerimit do të mund të vazhdojë vetëm pas rregullimeve institucionale brenda BE-së, Shqipëria duhet t'i vendosë reformat e kërkuara nga Brukseli, si prioritete të politikës së saj. Strategjia e Zgjerimit thotë se, zbatimi me rigorozitet i detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja përbën garancinë e vetme për kalimin në fazat e tjera që do t'i paraprijnë anëtarimit të Shqipërisë në BE.

Treguesi elokuent i ngërcit politik shqiptar e për rrjedhje edhe të mungesës së reformave rrënjësore që imponon procesi i integritit është edhe axhenda ndërmjet Brukselit dhe Tiranës, e cila duket e përqendruar vetëm në çështjet e sigurisë, antikorrupsionit dhe standardeve zgjedhore, duke krijuar te qytetarët shqiptarë gabimisht përshtypjen se procesi i integritit evropian barazohet vetëm me këto elementë. Në të kundërt, kjo është vetëm maja e ajsbergut, sepse transformimi i vërtetë i vendit do të kushtëzohet, përveç kriterëve të lartpërmendura, te reformat rrënjësore në fushën e tregut dhe atë të drejtësisë.

Me gjithë rëndësinë që paraqet respektimi i standardeve zgjedhore dhe progresi në luftën ndaj korrupsionit, trafikeve dhe krimit të organizuar, procesi i integritit evropian nuk duhet barazuar vetëm me to. Perkundrazi, duhet shndërruar në një proces shumëpërmasorë zhvillimi, modernizimi dhe transformimi të vendit, në përputhje me standardet evropiane të sanksionuara në *acquis communautaire*. Ndaj, është mëse e nevojshme që politika shqiptare e në radhë të parë qeveria si aktorja kryesore në proces të firmosë një "armëpushim" me aktorët e tjerë politikë në funksion të axhendës reformiste. Axhenda reformiste dhe zhvilluese e Shqipërisë para së gjithash duhet të kalojë përmes hullinjëve kushtetues dhe institucional të demokracisë të cilat kanë përparësi në raport me stabilitetin. Krizat politike ciklike që përjetoj vendi në pjesën e dytë të vitit 2006 janë dëshmi e gjallë e faktit se MSA-ja nuk mund të jetë një *charte blanche* që mund të aktivizohet në momente të vështira për qëllime elektorale.

Përkundrazi, Shqipëria nuk ka luksin të qëndrojë për vitë me radhë në *stand by* duke dëgjuar të njëjtën frazë nga vendet anëtare të BE-së se "cdo gjë varet nga ju", si pasojë e mungesës së vizionit që nuk shtrihet përtej mandatit politik qeverisës.

Ditmir Bushati

Nga Veprimtaria e Kuvendit për muajin shkurt 2007

Kuvendi i Shqipërisë, për muajin shkurt, ka miratuar disa projektligje, ndër të cilët ishte edhe projektligji “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 7895 datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar*” (K.P.).

Ndryshimet në kodin penal janë iniciativë e Këshillit të Ministrave në bazë të neneve 81 pika 2 dhe 83 pika 1 e Kushtetutës.

Projektligji është shqyrtuar paraprakisht nga Komisioni i ligjeve, administratës publike dhe të drejtave të njeriut, ku i janë bërë edhe ndryshimet e nevojshme dhe përfundimtare projektligjit në fjalë.

Konsideruar fenomenet ndërkombëtare dhe rritjen e aktiviteteve të brendshme dhe të jashtme të një shteti, aktiviteteve ekonomike, juridike, sociale në të gjitha fushat, duke rritur edhe intensitetin e komunimit dhe shpejtësinë e tij ndërmjet shteteve, duke parë edhe fenomene të ndryshme kryesisht në fushën e kriminalitetit ndërkombëtar, është tashmë konsideruar edhe fenomeni i terrorizmit ndërkombëtar, trafikimi i qenieve njerëzore, trafikimi i substancave të ndryshme *inter alia* në rrugë të jashtëligjshme fenomene këto që janë paraqitur masivisht edhe në Shqipëri, nga nevojat e reja që kanë lindur për të rregulluar këto fenomene, fryte të globalizimit, është parë e nevojshme që kodi penal i Republikës së Shqipërisë, me gjithë amendimet e bëra, ka shfaqur disa mangësi të cilat janë pasqyruar në ligjin e aprovuar në Kuvend gjatë muajit shkurt. Këto ndryshime vijnë jo vetëm si pasojë e fenomeneve por edhe për faktin se Shqipëria ka ratifikuar disa marrëveshje ndërkombëtare të cilat, sipas nenit 121 të Kushtetutës përbëjnë burim të së drejtës së brendshme për shtetin shqiptar. Ligji i kaluar tashmë nga Kuvendi i Shqipërisë dhe që pritet të hyjë në fuqi sipas dispozitave të tij, pasuron kodin penal në respektim të angazhimeve të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. Ky ligj kryesisht konsideruar sa më sipër dhe disa fenomene të brendshme mund të përmbledhet në 4 drejtime: veprimet me qëllime terroriste, *tortura, informacioni i rezervuar dhe gjakmarja*.

Bashkimi European në shtyllën e tretë të tij, në bashkëpunimin gjyqësor dhe në çështjet e brendshme ka konsideruar të një rëndësie të veçantë luftën kundër terrorizmit, në të gjitha format e tij. Për këtë, Këshilli ka miratuar vendimin kuadër për luftën kundër terrorizmit nr.2002/475/GAI, datë 13 qershor 2002.

Në arenën juridike ndërkombëtare është e vështirë të gjesh një përkufizim të *terrorizmit* megjithatë, vendimi kuadër parashikon disa raste që konsiderohen të tilla. Projektligji në fjalë është bazuar tek ky vendim dhe duke konsideruar këtë nuk kufizohen rastet e veprimeve me qëllime terroriste.

Për Qeverinë shqiptare, në kuadrin e integritit evropian, amendimi i Kodit Penal bazuar në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (neni 5, 8 pika 3, 82, 84 dhe neni 85) është i domosdoshëm për të përafuar legjislacionin shqiptar me *acquis communautaire*. Duke konsideruar prioritetet e procesit të integritit në aspektin e parë të dhënies së përkufizimeve, në ligjin e mëparshëm konsideroheshin vetëm aktet terroriste, aspektin fenomenal të tyre. Me fjalë të tjera, ndëshkoheshim vetëm aktet terroriste. (neni 7 pika c KP). Diferenca midis akteve terroriste dhe veprimeve me qëllime terroriste (në ligjin e ndryshuar) qëndron në shtrirjen e fushës së veprimeve. Veprime (ose vepra) terroriste mund të konsiderohen të gjithë ato veprime të renditura në nenin 15 të ligjit të ndryshuar i cili ndryshon nenin 230 të kodit penal, ku mund të përmenden përgatitja psikologjike, stërvitja fizike (*me qëllim*) për akte terroiste të mundëshme, njohja e teknikave të terrorit, të armëve të ndryshme, të gjitha këto çështje të trajtuara paraqiten në ndryshimet e fundit të kodit penal. Me gjithë parashikimet e mundshme në pikën 2 të nenit 230 të ndryshuar lista e veprave lihet e hapur në rast se mund të paraqiten fenomene të reja nga kjo pikëpamje.

Teksti shkruan: “*veprat me qëllime terroriste përfshijnë, por nuk kufizohen në:...*”

Kjo pikë e kodit është e rëndësishme përse i përket parandalimit të fenomeneve të tilla që po shqetësojnë arenën ndërkombëtare. Fenomene të ndryshme që kanë evoluar kohët e fundit duke paraqitur edhe vështirësi në përballjen e tyre, kanë bërë që legjislatori të lërë rrugë të hapur për fenomene që mund të paraqiten dhe që duhen trajtuar si akte apo veprime me qëllime terroriste. Në këtë aspekt duhen pasur parasysh edhe organizata (*organizim me mbi dy persona*) si IRA, ETA apo Brigade Rosse. Terrorizmi ndërkombëtar nuk identifikohet vetëm me atë terrorizëm islamik me të cilin tashmë jemi të bombarduar nga mediat. Fenomeni, për vetë rastet e sipërpërmendura, ka një shtrirje më të gjerë të konceptit.

Aspekt tjetër i këtij projektligji është edhe *koncepti i torturës* i bazuar në *Konventën Ndërkombëtare Kundër Torturës dhe Trajtime ose Ndëshkime të Tjera të Pamëshirshme, Çnjerëzore apo Poshtëruese*.

Në Kodin penal të pamodifikuar (neni 86) dënohet “*tortura dhe çdo akt tjetër çnjerëzor apo poshtëruese...*” Në nenin 87 përshkruhet tortura me pasoja të rënda shëndetësore dhe karakteri i tyre i përhershëm, siç mund të jenë gjymtimi, shëmtimi si dhe tortura që ka pasoje vdekjen. Në këtë rast dënimi dyfishohet. Por nuk përcaktohen cilat janë aktet që mund të konsiderohen si torturuese.

(vijon në faqen 13)

Nga Veprimtaria e Kuvendit për muajin shkurt 2007

(vijon nga faqja 12)

Ndërsa në ligjin e ri përkufizohet tortura sipas Konventës kundër Torturës, neni 1 i saj.

Ndërsa në kodin penal lihej relativisht hapësirë për përkufizimin sipas rasteve të këtij lloj akti, në ligjin e ndryshuar rastet kur mund të konsiderohen të tilla, janë tashmë të cilësuar në rëndësinë e tyre

Në tekstin e projektligjit cilësohen si të tilla *kryerja me dashje e veprave nëpërmjet të cilave një personi i janë shkaktuar vuajtje të rënda fizike apo mendore, nga një person që ushtron funksione publike, ose me nxitjen apo miratimin e tij, të hapur ose të heshtur, me qëllim:*

a. për të marrë prej tij ose një tjetri informata ose pohime;

b. për të ndëshkuar për një veprim të kryer ose që dyshohet të jetë kryer prej/ose një personi tjetër;

c. për ta frikësuar ose bërë presion mbi të ose një personi tjetër;

ç. për çdo lloj qëllimi tjetër bazuar në çfarëdolloj forme diskriminimi;

d. çdo lloj akti tjetër çnjerëzor apo poshtërues, përbëjnë vepër penale..... (neni 10).

Pra shihet qartë tendenca e dy teksteve të ligjeve. Në rastin e parë të pranimit të torturës si akt penal ku nuk përshkruhet se cili akt mund të quhet torturues, në rastin e projektligjit jepet qartësisht se çdo lloj veprimi që ka si synim nxitjen për të marrë një informacion ose për arsye tjetër të paligjshme përbën një vepër për ndjekje penale.

Natyrisht, në nene përshkruhet edhe kush mund të ushtrojë këtë akt.

Përkufizimi në të njejtën linjë me konventat ndërkombëtare dhe me të drejtat e njeriut bën të mundur arritjen e standardeve ndërkombëtare të cilat kërkohen nga institucionet ndërkombëtare për të marrë pjesë në arenën ndërkombëtare me të drejta të plota në këto organizata, por në këtë aspekt është e rëndësishme si përjasja e ligjeve kombëtare me ato ndërkombëtare por sidomos respektimi i të drejtave dhe lirive të personave të sanksionuara fillimisht në Kushtetutën e Shqipërisë e cila është e bazuar në parimet demokratike.

Informacioni, transmetimi ose marrja e tij në rrugë të paligjshme si dhe deklaratave të rreme organeve të policisë gjyqësore kur ai klasifikohet sekret dhe për këtë arsye konsiderohet si një shkelje e rëndë për çështje sigurie etj.

Në kodin penal, përhapja e informacionit të kualifikuar si sekret shtetëror përmbahen në nenet 294 dhe 295 respektivisht dallohen nga përhapja e informacionit sekret nga *person i besuar* dhe nga *shtetasit*. Në modifikimet e fundit ligji 9686, datë 26.02.2007 shton pikën *a* në nenin 295 të KP në të cilën shtohet figura e funksionarit

publik në tregimin e të dhënave sekrete ose të një personi të ngarkuar në shërbim publik.

Në pikën *a* të nenit 295 të ligjit që ndryshon K.P. konsiderohen edhe tregimi i të dhënave sekrete në fushën e tregtisë industriale, zbulimi i të dhënave që përmbajnë akte sekrete nga prokurori, oficeri i policisë gjyqësore, si dhe zbulimi i të dhënave në procesin e bashkëpunimit, të mbrojtjes ose për vendndodhjen e dëshmitarëve, garanci dhe elementë juridike të cilët i shtohen duke pasuruar K.P.

Gjakmarrja është një fenomen që në shoqërinë shqiptare ka shkaktuar një numër të madh viktimash në territorin e Shqipërisë, dhe pasi janë kryer vrasje me një gjykim subjektiv konsideruar që normat që pretendohen të respektohen si *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, nuk janë më në fuqi dhe sot paraqiten me një anakronizëm perfekt. Natyrisht që një ligj të bëhet i tillë kërkon karakteristikat e tij si *opinio juris sive necessitatis* dhe *diuturnitas*. Këto ligje, në qoftë se sot mund të konsiderohen, nuk i kanë këto dy elemente duke marrë parasysh që janë fenomene të izoluara për në pjesë të territorit të Shqipërisë ku ato kanë një ndjeshmëri të lartë, kushtëzojnë jetën në këto vende. Mund të shihet raporti i fundit i Departamentit të Shteteve të Bashkuara për respektimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Ligji për disa ndryshime në K. P. parashikon edhe këtë fenomen të shoqërisë shqiptare në dënimin e tij dhe në mënyrë indirekte fton të dëmtuarit nga ky fenomen t'i drejtohen drejtësisë. Ligji i ri shton pikën *a* në nenin 83 të K. P. ku citohet gjakmarrja, në të cilin shkruhet "*kanosja serioze për hakmarrje ose gjakmarrje.....*, aspekt ky jo i konsideruar më parë në K. P.

Në ligjin që modifikon K.P. parashikohet si kanosja me qëllim gjakmarrjen e cila detyron persona për t'u mbydhur në shtëpi sipas zakoneve kanunore, si dhe nxitjen (neni 6 i ligjit që shton pikën *b* në nenin 83 të K.P.) për qëllime të tilla. Shtrirja e rasteve duhet të ndihmojë shoqërinë shqiptare për të dalë nga ky fenomen si dhe nga parime tashmë të tejkaluar nga shoqëritë demokratike. Këto janë disa nga pikat kryesore të ligjit 9686 datë 26.02.2007 të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë si domosdoshmëri në ecurinë e reformave të ndërrmarra nga qeveria shqiptare për të përafuar legjislacionin shqiptar me atë komunitar si angazhime në procesin e integritetit në strukturat e Bashkimit Europian.

Këto shënime nuk pretendojnë të jenë përfundimtare dhe ezauruese përse i përket kësaj lënde. U konceptuan të jenë vetëm një përmbledhje.

Denis Gila

Takimi i grupit të punës BE- Shqipëri për Transportin, Energjinë, Mjedisin dhe Zhvillimin Rajonal

15-16 shkurt 2007

(vijon nga faqja 1)

Nga ana e saj pala evropiane kërkoi sqarime në lidhje me miratimin dhe përfshirjen e Planit Kombëtar të Transportit në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, si dhe nevojën që ky Plan të kalojë në Parlament me qëllim përfshirjen e tij në buxhet. Një tjetër shqetësim i palës evropiane ishte se cilat autoritete janë informuar në kuadër të zbatimit të Nenit 33 të Marrëveshjes së Ndërmjetme si dhe kërkoi një informacion më të detajuar në lidhje me ekzistencën ose jo të një regjimi taksash në lidhje me trafikun tranzit. Përmirësimi i sigurisë rrugore ishte një tjetër rekomandim i palës evropiane. Për të gjithë shqetësimet e mësipërme pala evropiane mori informacionin e duhur nga përfaqësuesit e MPPTT.

Më pas diskutimi u fokusua në zhvillimet më të fundit në *Transportin Hekurudhor*. Prezantimi u fokusua në zhvillimet e kuadrit ligjor dhe modernizmin dhe rikonstruktimin e hekurudhës shqiptare.

Pas prezantimit, *diskutimi i palës evropiane u fokusua në: liberalizimin e tregut në këtë sektor, autoritetin i cili garanton operatorët për zhvillimin e këtij tregu të hapur, përafrimin e legjislacionit në këtë fushë si dhe rekomandoi palën shqiptare për rritje të pjesëmarrjes në nismat rajonale në sektorin hekurudhor, kryesisht në linjat, që janë pjesë e Korridorit VIII.*

Takimi vijoi me prezantimin e zhvillimeve më të rëndësishme të ndërmara në sektorin e *Transportit Ajror*. Pala shqiptare vuri theksin në përgatitjen e draftit të Kodit Ajror, i cili synon të përfarohet me legjislacionin evropian si dhe aktivitetet e ndërmara pas anëtarësimit në ECAA.

Nga ana e saj, pala evropiane inkurajoi progresin në këtë fushë dhe rekomandoi se paralelisht me përafrimin e legjislacionit në këtë fushë, institucionet shqiptare duhet të bëjnë kujdes edhe për rritjen e standardeve të sigurisë në aviacionin civil, për të cilën siguroi palën shqiptare për mbështetjen e saj. Në fund pala evropiane i kërkoi palës shqiptare edhe një raportim më të shpejtë për asistencën teknike me qëllim realizimin e objektivave në këtë fushë.

Pas prezantimit të zhvillimeve të fundit në fushën e *Transportit Detar*, ku theksi u vu në: përfarimin e legjislacionit, rritjen e sigurisë në ujërat dhe portet shqiptare si dhe në aktivitetet e ndërmara me qëllim ngritjen e administratës detare, *pala evropiane rekomandoi rritjen e shkallës së sigurisë si dhe një informacion, me shkrim, më të detajuar në lidhje me numrin e anijeve, gjendjen e tyre, numrin e*

punonjësve të administratës detare etj. Informacioni ju përcoll në ditën tjetër të takimit.

ENERGJIA

Përfaqësuesit e METE prezantuan arritjet kryesore gjatë vitit 2006 në fushën e *energjisë* lidhur me masat e marra me qëllim përditësimin dhe zbatimin e angazhimeve që rrjedhin nga *Traktati i Energjisë*, situata e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët dhe masat e marra në kuadër të eliminimit të krizës energjetike, situata aktuale për ndërtimin e TEC-it të Vlorës dhe përditësimin e masave të ndërmara për nxitjen e efikasitetit energjetike dhe përdorimin e burimeve të reja energjetike,

Pas inkurajimit të palës shqiptare për përpjekjet e bëra në këtë fushë pala evropiane ngriti disa shqetësime lidhur me : “(i) planin e qeverisë për përballimin e gjendjes së vështirë energjetike, (përfaqësuesja e palës komunitare tha se “*situata energjetike shqiptare nuk mund të jetë më keq se ç’është aktualisht. Sigurimi i energjisë elektrike i kushton Shqipërisë rreth 1 milion euro në ditë, dhe se po të vazhdojë kështu rrezikon falimentimin*” (ii) arsyet e kalimit në KESH të të drejtës së prokurimit të drejtpërdrejtë për importin e energjisë elektrike, (iii) cilat do të jenë objektivat afatshkurtra dhe afatgjata të Planit të Veprimit në Sektorin Elektroenergjetik dhe mundësitë e realizimit të tyre, në zbatim të Traktatit të Energjisë, (iv) cilat janë masat e ndërmara për përmirësimin e targeteve të KESH, me qëllim reduktimin e humbjeve në rrjet dhe rritjen e arkëtimit si dhe (v) në kontratën për ndërtimin e TEC-it Vlorë a janë marë parasysh kushtet për mbrojtjen e ambientit; dhe (vi) a do të ketë zgjerime të TEC-it të Vlorës.

Pala evropiane gjithashtu rekomandoi se në përputhje me legjislacionin komunitar, nuk duhet të jepen me konçension HEC-et si ndërmarje prodhuese të energjisë. Një tjetër rekomandim ishte mbështetja e Strategjisë së Energjisë në diversifikimin e burimeve energjetike për sigurimin e furnizimit me energji të popullsisë, pavarësisht se Shqipëria është një vend shumë i pasur me burime ujore. Ndër të tjera u theksua që më shumë përpjekje nevojiten në drejtim të:

- disiplinimit të konsumatorëve të energjisë elektrike;
- zvogëlimit të sasisë së energjisë që përdoret për ngrohje;
- pagimi i energjisë së konsumuar.

(vijon në faqen 15)

Takimi i grupit të punës BE- Shqipëri për Transportin, Energjinë, Mjedisin dhe Zhvillimin Rajonal

15-16 shkurt 2007

(vijon nga faqja 14)

Pala komunitare kërkoi tekstet e ligjit mbi koncesionet dhe projekt ligjit mbi prokurimin e energjisë nga KESH.

Pala komunitare sugjeroi se qeveria shqiptare duhet të organizojë një takim me Komisionin Evropian dhe komunitetin e donatorëve për të adresuar me masa konkrete problemet në fushën energjetike.

Të gjitha shqetësimet e ngritura nga pala evropiane morën përgjigje nga anëtarët e grupit të METE.

ZHVILLIMI RAJONAL

Në vijim të takimit diskutimi u përqendrua në paraqitjen e kuadrit ligjor në fushën e *zhvillimit rajonal* si dhe në zhvillimet më të fundit në kuadër të bashkëpunimit ndërkuftar. Përfaqësuesi i METE vijoi me një prezantim të Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal. Mungesa e një legjislacioni konkret në këtë fushë, një zhvillim ekonomik i pabalancuar si dhe problemet e varfërisë në rajonet e thella të vendit, ishin disa nga faktorët që çuan në hartimin e kësaj Strategjie. Qëllimi i saj është zhvillimi i balancuar ekonomik në të gjithë rajonet e vendit, nëpërmjet politikave nxitëse. Duke qenë se një pjesë shumë e rëndësishme e zhvillimit rajonal është edhe klasifikimi i rajoneve, INSTAT, vijoi me një prezantim të klasifikimit të adoptuar aktualisht nga Shqipëria. Aktualisht klasifikimi i adoptuar është NUTS I, kjo për vetë specifikën e Shqipërisë. Në periudhën afatmesme parashikohet adoptimi i klasifikimit NUTS II. Të pranishëm në takim ishin edhe përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, të cilët i prezantuan palës evropiane bashkëpunimin e ofruar prej tyre në kuadër të hartimit të Strategjisë së Zhvillimit Rajonal, si dhe diskutuan në lidhje me rishikimin e ndarjes administrative.

Pala komunitare inkurajoi palën shqiptare dhe u interesua për asistencën financiare, e cila mbështet INSTAT dhe METE në këtë fushë. Pas një diskutimi në lidhje me programet nga të cilat përfitojnë institucionet shqiptare në këtë fushë, pala evropiane shprehu mbështetjen e saj dhe inkurajoi palën shqiptare për të përfituar nga fondet që Bashkimi Evropian do të akordojë edhe në kuadër të IPA-s.

Sa i përket zhvillimeve në fushën e *bashkëpunimit ndërkuftar*, duke qenë se materiali i prezantuar për këtë pikë, si dhe duke marrë në konsideratë komunikimin e shpeshtë ndërmjet anëtarëve të Delegacionit Evropian dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Integritetit për këtë çështje, nuk pati ndonjë koment të veçantë nga pala evropiane.

MJEDISI

Prezantimi për çështjet e mjedisit u hap nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPAU-së, i cili foli për punën e bërë gjatë vitit 2006 në lidhje me Strategjinë Kombëtare të përafrimit të legjislacionit me Acquis, në zbatim të të cilës janë ndërmarrë një sërë iniciativash të cilat kanë synuar hartimin e disa akteve ligjore të reja dhe përmirësimin e atyre ekzistuese. Në lidhje me situatën e përafrimit të legjislacionit kombëtar me Acquis u përmend hartimi dhe miratimi i një sërë iniciativave ligjore si më poshtë: miratimi në qeshor 2006 i ligjit për Mbrojtjen e Biodiversitetit; miratimi në maj 2006 i ligjit “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”; miratimi i rregullores “Për trajtimin e mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transportimi dhe deri tek asgjësimi i tyre”, e cila është hartuar në përputhje me ligjin “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”; projekt-VKM “Për miratimin e cilësisë së lëndëve djegëse benzinë dhe diziel”, e cila transponon Direktivën 98/70/EC; projekt- ligji “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, e cila transponon direktivën 2002/49/EC me të njëjtin titull.

Pala komunitare theksoi se projekti i monitorimit të progresit për mjedisin është një nga projektet më të rëndësishme për vendet që aspirojnë të aderojnë në BE. Në këtë kuadër BE mirëpret një tabelë informuese mbi gjendjen e transpozimit dhe të zbatimit të legjislacionit komunitar në këtë fushë, duke përfshirë të dhëna të monitorimit e gjendjes mjedisore për vitin 2005 dhe 2006.

Pala komunitare kërkoi gjithashtu informacion lidhur me afatin e miratimit të Strategjisë për mjedisin. Përfaqësuesi i palës shqiptare sqaroi se kjo strategji sektoriale do të miratohet në prill 2007 dhe se ajo do të jetë pjesë e Strategjisë Kombëtare për zhvillim dhe integrim.

Pas diskutimit të kësaj pike, pala shqiptare prezantoi politikën dhe aktivitetet të ndërmarra gjatë periudhës 2005-2006 lidhur me pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe veçanërisht informimin e publikut për çështje të ndryshme të mjedisit. Në këtë kuadër u theksua rëndësia e ngritjes së qendrës së informimit Arhus në dhjetor 2006. Pala komunitare kërkoi të informohet lidhur me aktivitetin e kësaj qendre si dhe me iniciativat që do të ndërmerren me qëllim zhvillimin e qendrave të tjera. Përfaqësuesi i palës shqiptare u angazhua të raportonte mbi këtë çështje

(vijon në faqen 16)

Takimi i grupit të punës BE- Shqipëri për Transportin, Energjinë, Mjedisin dhe Zhvillimin Rajonal

15-16 shkurt 2007

(vijon nga faqja 15)

në muajt qershor-korrik 2007 me anë të një raporti mbi aktivitetet e qendrës së informimit.

Në kuadër të vlerësimit të impaktit në mjedis, pala komunitare kërkoi nga pala shqiptare një informacion të shkruar mbi listën e projekteve – subjekt të vlerësimit të impaktit në mjedis.

Nga pala europiane me shumë interes u kërkua informacion mbi strukturën e Ministrisë së Mjedisit, funksionimin e saj, si dhe për bashkëpunimin ndërinstytucional për çështjet mjedisore.

Sekretari i Përgjithshëm i MMPAU-së prezantoi strukturën e re të kësaj ministrie, në të cilën janë shtuar sektorë si ai i Pyjeve, Administrimit të Ujërave dhe Peshkimit. Ai theksoi se ky ristrukturim e ka bërë më të gjerë fushën e veprimtarisë të kësaj ministrie dhe ka krijuar më shumë hapësirë për koordinimin mes tyre. Me anë të kësaj strukture të re janë ndarë përgjegjësitë e kontrollit, liçensimit dhe hartimit të politikave. Ai shtoi gjithashtu se përgjegjësitë e stafit të MMPAU-së lidhen dhe ndahen me përgjegjësitë e autoriteteve lokale si p.sh për administrimin e mbetjeve. Pas ristrukturimit të ministrisë janë organizuar disa trajnime dhe workshop-e për stafin e ri.

Në lidhje me bashkëpunim ndër-instytucional gjatë vitit 2006 MMPAU ka bashkëpunuar me ministrinë e linjës dhe institucionet të tjera, si dhe ka qenë palë e takimeve dhe tavolinave të rrumbullakëta për çështje e mjedisit. Ajo ka dërguar ligjet e hartuar prej saj për mendim në ministrinë e linjës, po ashtu ka dhënë mendime për ligjet e hartuara nga institucionet e tjera, si dhe ka marrë pjesë në grupe pune që në fazat e hartimit të ligjeve në ministrinë e linjës. Gjithashtu ka bashkëpunuar me vendet e rajonit lidhur me komisionet e përbashkëta për ujërat ndërkomunitare. Gjithashtu u përmend dhe bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për hartimin e një rregullore të përbashkët “Mbi parandalimin e ndotjeve negative në shëndet dhe mjedis nga aktivitetet ndërtuese”.

Më tej palët u fokusuan në çështjen e monitorimit të ajrit, rrjeti i të cilit aktualisht është shtrirë në 7 qytete të vendit dhe në 15 stacione monitorimi. Rezultatet e monitorimit të vitit 2006 tregojnë se në shumë zona është ende problem cilësia e ajrit urban. Nga të dhënat e monitorimit në zonën industriale të Elbasanit rezultojnë përmirësime në drejtim të cilësisë së ajrit nisur nga disa masa të marra për respektimin e kërkesave të ligjit për mjedisin, ndërsa për Tiranën ka përmirësim vetëm në një stacion monitorimi. Të

pyetur nga pala europiane për masat e marra për këtë çështje, pala shqiptare u përgjigj se do të bashkëpunohet më tej me ministrinë e linjës (MPPTT dhe METE) si dhe organet e pushtetit vendor për disiplinimin e veprimtarive të sektorëve të ndërtimit dhe të transportit. Problem mbetet mosfunksionimi shpesh herë i filtrave për shkak të mungesës së energjisë elektrike. Pala komunitare kërkoi një plan lidhur me aktivitetet e ardhshme për trajtimin e problemeve të ndotjes së ajrit.

Një pikë tjetër e axhendës ishte diskutimi mbi TEC-in e Vlorës dhe impaktin e tij në mjedis. Pala europiane ishte e interesuar të dinte se në cilën pikë ka mbetur projekti për zbatimin e tij, duke qenë se kontrata është nënshkruar midis kompanisë amerikane MWH dhe KESH. Në lidhje me këtë pikë Sekretari i Përgjithshëm i MMPAU-së sqaroi se nuk është ajo ministria përgjegjëse për ndërtimin e tij. Gjatë periudhës prill-maj 2003 MMPAU realizoi studimin e vlerësimit të ndikimeve në mjedis nga zbatimi i projektit të TEC në Portin e Ri të Vlorës të përzgjedhur nga kompania Amerikane MWH bazuar në legjislacionin vendas, udhëzimet e Bankës Botërore dhe BERZH. Raporti i VNM për projektin e TEC Vlorë u paraqit në MMPAU për të dhënë opinionin e saj dhe pasi ajo ra dakort me përmbajtjen e tij subjekti mund të niste procedurat e marrjes të lejes mjedisore për zbatimin e projektit bazuar në kërkesat e ligjit 8990 datë 23.01.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”. Kërkesa për këtë leje nuk është dërguar akoma në MMPAU. *Pala europiane kërkoi të informohet mbi planin konkret të TEC-it të Vlorës.*

Më tej takimi vazhdoi me diskutimin e veprimtarive që janë ndërmarrë apo do të ndërmerren për pikat e nxehta mjedisore (Hot Spots).

Sekretari i Përgjithshëm i MMPAU-së nënvizoi se qëllimi kryesor i punës të këtij institucioni është reduktimi i ndotjeve të mjedisit veçanërisht atyre të shkaktuara nga pikat e nxehta. Janë ndërmarrë disa masa për disa nga hot spot-et si:

Në ish ndërmarrjen kimike në Durrës në Porto Romano me mbështetjen e Bankës Botërore është kryer një studim fizibiliteti për rehabilitimin e zonës dhe po kryhet një studim tekniko-inxhinjerik i zonës e më pas do të kalohet në inkapsulimin e mbetjeve. Për ish uzinën e sodës-PVC në Vlorë gjatë 2006 ka përfunduar studimi parainvestues për rehabilitimin e zonës. Për uzinën e superfosfatit në Laç dhe për

(vijon në faqen 17)

Takimi i grupit të punës BE- Shqipëri për Transportin, Energjinë, Mjedisin dhe Zhvillimin Rajonal

15-16 shkurt 2007

(vijon nga faqja 16)

kombinatit e metalurgjikut në Elbasan pritet të bëhen studime dhe më tej rehabilitimi fizik i zonës në mbështetje të programit CARDS. Projekti i "vendeve të groposjes të rrezikshme" të financuara nga programi CARDS 2004, 2005 dhe 2006 është në pikën e studimit të ndërtimit të CDF (confined disposal facilities) në Fier dhe në Rubik. Për vendshkarkimin e mbeturinave në Sharrë (Tiranë) ishte përfaqësuesi i MPPTT i cili foli për gjendjen aktuale. Ai sqaroi se Sharra është një ndër Hot Spot-et kryesor që ka impakt në shëndetin e njerëzve. Në mbështetje të *Cooperazione Italiana* u bë i mundur financimi me 6.4 milion euro dhe së shpejti do të fillojë rehabilitimi dhe marrja e masave për mbylljen e plotë të saj sipas standarteve.

Në lidhje me *grumbullimin e mbetjeve* nga një studim i bërë nga MPPTT rezultoi se administrimi i mbetjeve lë për të dëshiruar. Është rritur sasia e mbetjeve urbane dhe inerte (me 3,5% në vit) si pasojë e rritjes së konsumit, si dhe faktori tjetër dominues, atij të mungesës të qytetarisë në hedhjen e mbetjeve në vendin e caktuar. *Pala europiane sugjeroi nxitjen e projekteve për ndërgjegjësimin dhe edukimin e qytetarëve për hedhjen e mbetjeve.* Ndërsa për ricklimin e mbetjeve pala shqiptare shpegoi se disa kompani private kanë filluar të veprojnë në këtë fushë, por sasia e ricikluar është shumë e vogël. U përmend procesi i fabrikës së Birrës Tirana e cila ripërdor shishet e birrës. Aktualisht ka disa projekte si p.sh për administrimin e mbetjeve të ngurta në Korçë të financuara nga Qeveria Gjermane dhe Banka Botërore.

Gjithashtu nga pala Komunitare u kërkua një informacion më i zgjeruar lidhur me progresin mbi infrastrukturën, mbledhjen, riciklimin si dhe politikën e miratuarë përsa i përket riciklimit të mbetjeve.

Pala komunitare kërkoi një vlerësim të projekteve në zbatim, të problemeve që adresojnë si dhe të fondeve të alokuara, donatorë të tjerë që mund të angazhohen lidhur me trajtimin e hot spotëve mjedisore.

Më pas u diskutua për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme, të cilat përfaqësuesi i MPPTT i cilësoi me një impakt shumë të madh në mjedis. Ai nënvizoi se, depozitimi i tyre aktualisht nuk plotëson asnjë kriter. Ndryshimi i situatës kërkon kohë dhe investime. Këto të fundit, për të arritur standartet e BE, përveçse të brendëshme, nevojiten dhe nga donatorë. Në Strategjinë Kombëtare të Mjedisit e cila është në përfundim është parashikuar një fond për këtë pikë, por është i pamjaftueshëm për të përmbushur gjithë

nevojat. *Pala europiane kërkoi të dinte nëse MMPAU ka stafin e mjaftueshëm për implementim e ligjit të mbetjeve të rrezikshme dhe si dhe sa përqind nga Acquis për mbetjet e rrezikshme është transpozuar në legjislacionin kombëtar.* Sekretari i Përgjithshëm i MMPAU-së u përgjigj se ka mangësi në stafin e duhur për të zbatuar legjislacionin e BE-së në këtë fushë dhe se aktualisht është bërë kërkesë për rritje stafi.

Përsa i përket transpozimit të Direktivës IPPC (mbi kontrollin e parandalimit dhe ndotjes industriale, pala shqiptare informoi se direktiva nuk është transpozuar ende në legjislacionin vendas. Lidhur me këtë çështje u theksua se për menaxhimin e mbetjeve në MMPAU nevojitet shtesë stafi.

Pala shqiptare sqaroi se duke qenë se menaxhimi i mbetjeve është një çështje ndër-institucionale, një pjesë e përgjegjësisë në menaxhimin e mbetjeve i takon dhe bashkive e komunave

Në lidhje me pikën tjetër të axhendës, *për strategjinë e furnizimit me ujë*, pala shqiptare nënvizoi nevojën e rishikimit të kësaj strategjie për shkak të mungesës së një plani veprimi që do të mundësonte zbatimin strategjisë si dhe të rezultateve të vogla të kësaj strategjie. Në fund të takimit u paraqit nga pala shqiptare prezantimi mbi disa nga raportimet kombëtare për konventat ndërkombëtare.

Interesit të pales komunitare lidhur me eco-tax, zbatimin e saj, shkeljet e mundshme të ligjit, pala shqiptare iu përgjigj se shifrat kjo taksë mbledhet në përputhje me dispozitat e ligjit dhe se shifrat e mbledhjes së saj janë në të njëjtin nivel me një vit më parë. (një material i shkruar u kërkua nga pala komunitare lidhur me këtë çështje)

Pala komunitare kërkoi të informohej lidhur me projektin Fondin Mjedisor (ECO-Fund), i cili është parashikuar dhe në programin e qeverisë.

Mbyllja e takimit

Pala komunitare mirëpriti informacionin e dhënë nga pala shqiptare në këtë takim duke e konsideruar atë të frytshëm. *Pala komunitare kërkoi përqendrimin e punës për zbatimin e legjislacionit në këto fusha dhe ofroi asistencën e zyrës së TAIEX për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë komunitar.*

Ditmir Bushati

Projektligji për disa ndryshime në ligjin nr.8560 dt.22.12.1999 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar

PROJEKTLIGJI PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8560, DATË 22.12.1999, “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”.

TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

Në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 37 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 37 Pagimi i tatimeve, taksave dhe kontributeve

1. Pagimi i tatimeve, taksave dhe kontributeve të sigurimeve, shoqërore e shëndetësore, është i detyrueshëm brenda afateve të përcaktuara me ligje të veçanta tatimore.

2. Pavarësisht nga dispozitat e parashikuara në këtë ligj apo në ligje të tjera të veçanta tatimore, shuma e detyrimit për t’u paguar nga tatimpaguesit, me vlerë deri në 1 000 (një mijë) lekë, në përputhje me deklaratën tatimore apo vlerësimin tatimor, trajtohet si detyrim në vlerë zero.”.

Neni2

Neni 41, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni41 Pagesa me këste

Në raste të veçanta dhe të argumentuara me gjendjen financiare, kur një tatimpagues nuk mund të paguajë plotësisht dhe menjëherë detyrimin tatimor, organi tatimor përkatës, sipas kërkesës me shkrim, mund të hartojë një plan pagesë me këste. Në raste të tilla, tatimpaguesi paguan interesat për të gjithë kohëzgjatjen e pagesës me këste. Plani i pagesës me këste është një marrëveshje me shkrim, e përgatitur sipas përcaktimit në Kodin Civil dhe e nënshkruar nga kryetari i degës përkatëse të tatimeve, si dhe nga tatimpaguesi. Plani i pagesës me këste anulohet, kur kushtet, në të cilat është hartuar, nuk ekzistojnë më.”.

Neni 3

Neni 43 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 43 Detyrimi për pagesë të menjëhershme

1. Para se të paraqiten për apelim, në shkallët e apelit administrativ, tatimpaguesit janë të detyruar të parapagujnë detyrimin tatimor, pa përfshirë interesat dhe gjobat, që lidhen me këtë detyrim.

2. Para se të paraqiten për apelim, në shkallët e apelit për shqyrtim gjyqësor, tatimpaguesit janë të detyruar të paguajnë çdo gjobë dhe interes, që lidhet me detyrimin tatimor të apeluar.”.

Neni 4

Neni 49 ndryshohet, si më poshtë vllon:

“Neni 49 Shkeljet dhe dënimet për regjistrimin

1. Kryerja e veprimtarisë pa u regjistruar në organet tatimore dhe pa u pajisur më parë me certifikatën tatimore është shkelje dhe dënohet, si më poshtë vijon:

a) Me bllokim të veprimtarisë, deri në regjistrimin e tatimpaguesit dhe pajisjen e tij me certifikatë tatimore. Në rastin e transportit, ky dënim shogërohet me marrjen e lejes së garkullimit të automjetit të paregjistruar dhe të papajisur me certifikatë tatimore.

b) Me sekuestrim të pasurive në vendin e biznesit; kur tatimpaguesi, ndaj të cilit është marrë masa e bllokimit, gjendet duke ushtruar veprimtarinë.

2. Mosnjoftimi në degën e tatimeve i ndryshimeve në regjistrim, që kanë të bëjnë me adresën e vendit të ushtrimit të veprimtarisë, është shkelje dhe dënohet, si më poshtë vijon:

a) Me bllokim të veprimtarisë, deri në regjistrimin e adresës së re të vendit të ushtrimit të saj, dhe pajisjen e saj me certifikatë dytësore tatimore. Në rastin e transportit, ky dënim shogërohet me marrjen e lejes së garkullimit të automjetit të paregjistruar dhe të papajisur me certifikatë dytësore tatimore.

b) Me sekuestrim të pasurive në vendin e ri të biznesit, kur tatimpaguesi, ndaj të cilit është marrë masa e bllokimit, gjendet duke ushtruar veprimtarinë.”.

Neni 5

Neni 55 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 55 Shkeljet dhe dënimet për mosdokumentim

Ruajtja, përdorimi dhe transportimi i mallrave pa dokumentacionin e përcaktuar në udhëzimin e ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji, është shkelje dhe dënohet me sekuestrimin e mallrave të padokumentuara.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

RELACION

Ndryshimet e propozuara në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, synojnë përmirësimin e procedurave administrative për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara dhe rritjen e efektivitetit të masave shtrënguese ndaj tatimpaguesve,

(vijon në faqen 19)

**Projektligji për disa ndryshime në ligjin
nr.8560 dt.22.12.1999 "Për Procedurat
Tatimore në Republikën e Shqipërisë" të
ndryshuar**

(vijon nga faqja 18)

që ushtrojnë veprimtari ekonomike informale. Ato konsistojnë në:

1. mosmarrjen parasysh të detyrimeve tatimore të vogla, me vlerë 1 mijë lekë dhe më pak. Kjo masë propozohet të merret për të shmangur një kosto të panevojshme administrative si për tatimpaguesin ashtu dhe për vetë administratën tatimore.

2. eliminimin e mundësisë së tatimpaguesve, që kontestojnë një detyrim tatimor dhe e apelojnë atë në shkallët e apelit administrativ, për të paragitur një garanci bankare për shumën e detyrimit të kontestuar. Me ndryshimin e propozuar tatimpaguesi, që apelon në shkallën e parë të apelit administrativ një detyrim tatimor, duhet të parapaguajë tatimin e papaguar pa gjobat dhe interesat, që lidhen me të. Kurse, tatimpaguesi që nuk ka fituar çështjen gjatë apelit administrativ dhe apelon në shkallën e parë të apelit gjyqësor, përpara se të bëjë një gjë të tillë duhet të parapaguajë të gjitha detyrimet e papaguara, që përbëhen nga tatimi i papaguar dhe nga gjobat e interesat, që lidhen me atë detyrim.

3. vendosjen e sanksioneve më të efektshme për të luftuar ekonominë informale. Sipas ligjit në fugi, tatimpaguesit e paregjistruar fillimisht dënohen me gjobë dhe më pas me mbyllje të veprimtarisë dhe sekuestro. Këto penalizime praktikisht nuk kanë rezultuar shumë efektive, pasi tatimpaguesit e dënuar me gjobë, nuk e paguajnë atë, ndërkohë që vazhdojnë të ushtrojnë veprimtari pa u regjistruar. Si pas propozimit të paraqitur, si masë e parë penali- zuese për tatimpaguesit e paregjistruar është parashikuar mbyllja e veprimtarisë dhe më pas vendosja e sekuestros mbi mallrat e gjendura në vendin e biznesit të paregjistruar, masa këto të cilat mendohet se do të jenë më efektive.

4. dhënien e të drejtës administratës tatimore për të sekuestruar mallrat e padokumentuara. Sipas ligjit në fugi, tatimpaguesi, të cilit i gjenden mallra të padokumentuara, dënohet vetëm me gjobë. Kjo gjobë praktikisht ka rezultuar si një masë joefektive për të luftuar evazionin fiskal. Për këtë qëllim propozohet që mallrat e gjendura pa dokumentacionin e duhur të sekuestrohen, në mënyrë që tatimpaguesit të mos kenë interes për të mbajtur apo transportuar mallra pa dokumentacion.

KËSHILLI I MINISTRAVE

**Kalendari i Punimeve të Kuvendit për
periudhën**

26 shkurt - 19 mars 2007

E Hënë, datë 26.02.2007, ora 17.00

-Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare, datë 6.02.2007.
3. Miratimi i Kalendarit të Punimeve të Kuvendit për periudhën 26 Shkurt – 19 Mars 2007.
4. P/Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9267, date 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime".

Për votim:

1. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, date 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Veprimtari në Komisione 27 Shkurt – 14 Mars 2007

1. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit teknik, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Japonisë".

· *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

· *Komisioni i Jashtëm*

· *Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

2. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen Europiane për linjat hekurudhore ndërkombëtare kryesore".

· *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

· *Komisioni i Jashtëm*

· *Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

3. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI), për financimin me kredi, të projektit "Ndërtimi i Terminalit të Trageteve dhe shesheve përreth, në Portin e Durrësit".

· *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

· *Komisioni i Jashtëm*

(vijon në faqen 20)

Kalendari i Punimeve të Kuvendit për periudhën 26 shkurt - 19 mars 2007

(vijon nga faqja 19)

- *Komisioni për Veprimtarisë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*
- *Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*
- 4. P/Ligji “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare “Për përgatitjen ndaj ndotjes nga nafta, reagimi dhe bashkëveprimi, (OPRC), 1990”.
 - *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*
 - *Komisioni i Jashtëm*
 - *Komisioni i Integritimit*
 - *Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*
- 5. P/Ligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 9367, date 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.
 - *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*
- 6. P/Ligji “Për një shtesë në ligjin nr. 9179, datë 20.01.2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”.
 - *Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*
 - *Komisioni i Sigurisë Kombëtare (e ka shqyrtuar)*
- 7. P/Ligji “Për organizimin, funksionimin, procedurat dhe detyrat e Komitetit Shqiptar të Birësim-it”.
 - *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*
 - *Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë*
- 8. P/Ligji “Për Fondin Kullosor”.
 - *Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*
- 9. P/Ligji “Për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet ndërkufitare”.
 - *Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*
- 10. P/Ligji “Për Portet Turistike në Republikën e Shqipërisë”.
 - *Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*
- 11. P/Ligji “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”.
 - *Komisioni për Ekonominë dhe Financat*
- 12. P/Ligji “Për Policinë e Shtetit”.
 - *Komisioni për Sigurinë Kombëtare*
- 13. P/Ligji “Për faljen e kamatëvonesave të papaguara të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”.
 - *Komisioni për Ekonominë dhe Financat*
- 14. Miratimi i Strukturës dhe Organikës së Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare.
 - *Komisioni për Ekonominë dhe Financat*
- 15. P/Ligji “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.
 - *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*
- 16. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.
 - *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*
- 17. Miratimi i Strukturës së Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit të Përpunimit të Ujrave të Ndotura (ERRU).
 - *Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*
 - *Komisioni i Ekonomisë dhe Financave*
- 18. Shqyrtimi i propozimit për anëtar të Bordit të ERE-së.
 - *Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*
- 19. P/Ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8673, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtërisë”, të ndryshuar.
 - *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*
- 20. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.
 - *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*
- 21. Miratimi i Strukturës Organizative të ERE-së.
 - *Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*
 - *Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*
- 22. Miratimi i Strukturës së Autoritetit të Konkurrencës.

(vijon në faqen 21)

Kalendari i Punimeve të Kuvendit për periudhën 26 shkurt - 19 mars 2007

(vijon nga faqja 20)

· *Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

23. Miratimi i Strukturës së Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

· *Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese,
Tregtinë dhe Mjedisin*

· *Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

Seanca Dëgjimore:

1. Raport i Komisionit të Shërbimit Civil “Për veprimtarinë e Komisionit të Shërbimit Civil për vitin 2006”..

· *Projektrezolutë për vlerësimin e punës të Institucionit të Komisionit të Shërbimit Civil.*

Komisioni Përgjegjës:

· *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

2. Informim i Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2006”..

Komisioni Përgjegjës:

· *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

· *Projektrezolutë për vlerësimin e punës të Institucionit të Prokurorit të Përgjithshëm.*

3. Raport i Avokatit të Popullit.

Komisioni Përgjegjës:

· *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

· *Projektrezolutë për vlerësimin e punës të Institucionit të Avokatit të Popullit.*

4. Raport i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Projektrezolutë për vlerësimin e punës të KLSH

Komisioni Përgjegjës:

· *Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

5. Raport i Autoritetit të Konkurrencës.

· *P/Rezolutë për vlerësimin e punës të Institucionit të Autoritetit të Konkurrencës.*

Komisioni Përgjegjës:

· *Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

6. Raport i Entit Rregullator të Telekomunikacionit (ERT).

· *Projektrezolutë për vlerësimin e punës të ERT-së.*

Komisioni Përgjegjës:

· *Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese,
Tregtinë dhe Mjedisin*

E Enjte, datë 1.03.2007, ora 10.00

-Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60’).

2. Miratimi i proces verbalit të seancës plenare, datë 26.02.2007.

3. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit teknik, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Japonisë”.

4. P/Ligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen Europiane për linjat hekurudhore ndërkombëtare kryesore”.

5. P/Ligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 9367, date 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të intereseve në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

E Hënë, datë 5.03.2007, ora 17.00

- Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60’).

2. Miratimi i proces verbalit të seancës plenare datë 1.03.2007.

3. P/Ligji “Për një shtesë në ligjin nr. 9179, datë 20.01,2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”.

4. Raport i Komisionit të Shërbimit Civil “Për veprimtarinë e Komisionit të Shërbimit Civil për vitin 2006”.

5. Miratimi i Projektrezolutës për vlerësimin e punës të Komisionit të Shërbimit Civil.

E Enjte, datë 8.03.2007, ora 10.00

-Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60’).

2. Miratimi i proces verbalit të seancës plenare datë 5.03.2007.

3. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI), për financimin me kredi, të projektit “Ndërti-

(vijon në faqen 22)

Kalendari i Punimeve të Kuvendit për periudhën 26 shkurt - 19 mars 2007

(vijon nga faqja 21)

mi i Terminalit të Trageteve dhe shesheve përreth, në Portin e Durrësit”.

4. P/Ligji “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare “Për përgatitjen ndaj ndotjes nga nafta, reagimi dhe bashkëveprimi, (OPRC), 1990”.

5. P/Ligji “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”.

6. P/Ligji “Për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet ndërkufitare”.

7. Raport i Avokatit të Popullit.

8. Miratimi i Projektrezolutës për vlerësimin e punës të Institucionit të Avokatit të Popullit.

E Hënë, datë 12.03.2007, ora 17.00

- Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60’).

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare datë 8.03.2007.

3. P/Ligji “Për organizimin, funksionimin, procedurat dhe detyrat e Komitetit Shqiptar të Birësim-it”.

4. P/Ligji “Për Policinë e Shtetit”.

5. Informim i Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2006”.

6. Shqyrtimi i propozimit për 1 anëtar të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë.

E Enjte, datë 15.03.2007, ora 10.00

-Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60’).

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare, datë 12.03.2007.

3. P/Ligji “Për Fondin Kullosor”.

4. P/Ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8673, date 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar.

E Hënë, date 19.03.2007, ora 17.00

-Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60’).

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare, date 15.03.2007.

3. Miratimi i Kalendarit të Punimeve të Kuvendit për periudhën 19 Mars – 9 Prill 2007.

4. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7843, date 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

5. Miratimi i Strukturës së ERU-së.

6. Miratimi i Strukturës Organizative dhe numri i punonjësve të ERE-së.

7. Miratimi i Strukturës së Autoritetit të Konkurrencës.

8. Miratimi i Strukturës së Entit Rregullator të Telekomunikacioneve (ERT).

9. Miratimi i Strukturës dhe Organikës të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare.

Bashkëpunëtorë për marrjen e informacionit mbi veprimtarinë e Qeverisë dhe të Kuvendit

Ditmir Bushati
Denis Gila
Klesta Hysi
Lindita Troka
Florjan Kalaja
Ermal Markaj

Stafi i Projektit

Sokol Berberi
Denada Breshanaj
Milaim Demnushaj

Qendra e Studimeve Parlamentare
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tiranë-Shqipëri Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascdpd.org

Collaborators for the information on Government and Assembly activities

Ditmir Bushati
Denis Gila
Klesta Hysi
Lindita Troka
Florjan Kalaja
Ermal Markaj

Project Staff

Sokol Berberi
Denada Breshanaj
Milaim Demnushaj

Centre for Parliamentary Studies
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascdpd.org